



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo




Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj

Department of Agriculture, Forestry and Rural Development



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 08 Më Dt. 03.01.2025
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

PLANI I PUNËS

2025

Janar, 2025

Përmbajtja

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....	3
PRIORITETET E DREJTORISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL.....	3
Tremujori i parë: janar, shkurt, mars.....	4
Tremujori i dytë: prill, maj, qershor.....	6
Objektivat kryesore në gjashtëmujorin e parë të vitit 2025	7
Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator.....	7
Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor	8
Objektivat kryesore në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025.....	9
PËRFUNDIM.....	9

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ushtron disa nga këto përgjegjësi:

- Ndërmerr masa të planifikimit dhe masat tjera që ndikojnë në përparimin e bujqësisë,
- Kujdeset të sigurojë, që tokat bujqësore të shfrytëzohen për prodhimtari bujqësore, me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së potencialit bujqësor në mënyrë të përhershme duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomike të Komunës,
- Kujdeset të përcaktohet shfrytëzimi, mbrojtja, rregullimi dhe qiradhënia e tokës bujqësore,
- Të monitorojë ndihma veterinare dhe të përkujdeset për mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve të kafshëve shtëpiake,
- Mbrojtjen e resurseve natyrore duke përfshirë pyjet, rërën dhe aktivitet për thyerjen e gurëve nga kompetenca komunale,
- Forcimin e bashkëpunimit në mes të fermerëve dhe grupeve të tjera të interesit, si dhe mundësi të mirë, për rritjen e kapaciteteve prodhuese bujqësore dhe blegtorale,
- Shërbime këshillimore, subvencionimet e fermerëve, zbatimi i projekteve kapitale të komunës dhe qeverisë në sektorin e bujqësi dhe blegtorisë,
- Mbrojtjen e pyjeve publike, pyjeve private si dhe pyjeve në prona publike të cilat janë në pronësi të ekonomisë së pyjeve, konform Ligjeve në Fuqi në Republikën e Kosovës,
- Mban evidencë për tokat bujqësore, llojet dhe sipërfaqet me kultura bujqësore, llojet kategoritë dhe numrin e krerëve të kafshëve shtëpiake, shoqëritë e bletëve, etj.

PRIORITETET E DREJTORISË SË BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Duke pasur parasysh se sektori i Bujqësisë është në fokusin kryesor të Komunës tonë, Drejtoria për BPZHR, për vitin 2025 ka paraparë që të vazhdojë mbështetjen e fermerëve për rritjen e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e bujqësisë, tërheqjen e investimeve, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve, rritjes ekonomike dhe të punësimit.

Duke u bazuar në planifikimin e buxhetit, përcjelljen e thirrjeve të MBPZHR-se për skemën e pagesave direkte dhe të grandeve, si dhe detyrave të tjera, prioritetet e drejtorisë do të kategorizohen në periudha tremujore.

Përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar-dhjetor 2025, stafi i drejtorisë për BPZHR do të jenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme për mbikëqyrjen dhe pranime teknike të projekteve kapitale pranë kësaj drejtorie, si dhe në komisione të tjera sipas nevojave dhe kërkesave që do të parashtrihen në drejtorinë tonë p.sh fatkeqësive natyrore si vërshime, breshër, erëra të fuqishme etj., të cilat kohëve të fundit po ndodhin shumë shpesh.

Në plan të parë do të jetë komunikimi dhe ofrimi i këshillave, i zyrtarëve të drejtorisë në raport me fermerët e komunës sonë që në numër nuk janë pak, mbi 3000.

Përkushtim i veçantë i DBPZHR-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës bujqësore për fermerët e vyeshëm të komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që vëmendje kryesore do të kenë:

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore
- Ndërtimi i kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes në bashkëpunim me kompaninë publike "KRU Dukagjini-Radoniq"
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përroskave,
- Shfrytëzimi racional i tokave bujqësore dhe pyjore që janë dhënë në shfrytëzim
- Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga zjarret

Tremujori i parë: janar, shkurt, mars

Fillimi i këtij tremujori do të karakterizohet me thirrjen për aplikim për subvencione për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024. Ky aktivitet është i ndërlidhur me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, por që nga praktika zakonisht thirrja hapet në gjysmën e muajit janar.

Pas përfundimit të fazës së aplikimit të gjitha dosjet do të dorëzohen në Agjencionin për zhvillimin e bujqësisë për të vazhduar me kontrollin administrative

Pranimi i aplikacioneve për qumësht	Aplikuesit	Koha e Realizimit
Plotësimi i dokumenteve dhe futja në sistemin eRF dhe LPIS	100 fermer	Janar - Shkurt

Gjatë kësaj periudhe po planifikohet që të hapet edhe thirrja **Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit**, për fermerët të cilët do ti plotësojnë kriteret të paraqitura në aplikacion.

Hapja e thirrjes "Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit"	Aplikuesit	Sipërfaqja e mbuluar	Koha e Realizimit
Përzgjedhja e fermerëve që i plotësojnë kriteret, publikimi i listave dhe shpërndarja e preparateve për këta fermerë	1000 vreshtarë	2400 ha	Shkurt - Maj

Gjatë kësaj periudhe po planifikohet që të bëhet edhe hapja e thirrjes për pleh artificial për fermerët, të cilët i plotësojnë kriteret të cilat do të paraqiten në aplikacion.

Hapja e thirrjes Përkrahja e fermerëve me PLEH ARTIFICIAL	Aplikuesit	Sasia e planifikuar	Koha e Realizimit
Përzgjedhja e fermerëve që i plotësojnë kriteret, publikimi i listave.	1200 Fermer	300,000kg	Mars-Maj

Tremujori i parë do të karakterizohet edhe me një proces shumë të rëndësishëm për DBPZHR-në pasi që do të vazhdojmë sërish edhe gjatë vitit 2025 me vaksinimin e bagëtive të trasha dhe të imta, në këtë mënyrë synojmë që të parandalojmë përhapjen e sëmundjeve të ndryshme në këtë sektor.

Vaksinimi i Bagëtive të trasha dhe të imta	Numri i Bagëtive që planifikohen të vaksinohen	Koha e Realizimit
Vaksinimi kryhet nga veterinari i punësuar në Komunë	Lopë-1900 Dele-7000	Shkurt-Mars

- Duke parë fermerët të kënaqur me furnizimin me fidanë dhe inpute për kulturën e kornishan ,Gjatë kësaj periudhe do të mundohemi të bëjmë marrëveshje edhe këtë vit me një Qendër Grumbulluese dhe për kultura të tjera bujqësore, përmes kësaj marrëveshje do të mbulojnë: Fidanet cilësore, Plehërimi dhe Riplehërimi (kristalorët), Pesticidet, Mulqerimi (Folia e zezë), Sistemi i ujitjes pikë-pikë.

- Do të organizojmë shërbime këshillimore për fermerët në kuadër të **projektit**: “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avansimit të shërbimeve Këshillimore të financuar nga MBPZHR dhe implementuar nga Qendra Kosovare për Zhvillim-KDC, krasitja dimërore dhe kultivimi i perimeve në ambient të mbyllur.
- Me përmirësimin e kushteve atmosferike do të fillojnë edhe punimet në projektet kapitale në sektorin e zhvillimit rural duke zbatuar projektet që paraprakisht kemi kontratë të lidhur me Operator Ekonomik.

Tremujori i dytë: prill, maj, qershor

Këtë periudhë tremujore do ta karakterizojë hapja e thirrjes për aplikim nga ana e MBPZHR-së për pagesave direkte- subvencione, ne si staf i drejtorisë synojmë të jemi të gatshëm të përballojmë fluksin e fermerëve gjatë kryerjes së procesit të aplikimit, synojmë të mobilizohemi me kapacitete të plota, si me staf poashtu edhe me mjete logjistike duke e ditur se komuna jonë ka numrin më të madh të fermerëve në nivel vendi.

Pas përfundimit të fazës së aplikimit të gjitha dosjet do të dorëzohen në Agjencionin për zhvillimin e bujqësisë për të vazhduar me kontrollin administrative dhe kontrollën e terrenit në mënyrë që të hapet rruga për pagesa të vitit 2025. Gjatë kësaj periudhe sikurse çdo vit zyrtarët e DBPZHR-së i procesojnë të dhënat në data bazë, ku në fund nxirret raport mbi të dhënat e fermerëve, më pastaj bëhet analizë me vitet paraprake mbi sipërfaqet e mbjella, llojet e pemëve dhe perimeve, sasinë, numrin e krerëve të bagëtive, numrin e shoqërive për bletë si dhe të dhënat e përfituara në euro “€” nga skema e pagesave direkte të Ministrisë së BPZHR-së.

Pranimi i aplikacioneve për Subvencione	Aplikuesit	Koha e Realizimit
Plotësimi i dokumenteve dhe futja në sistemin eRF dhe LPIS	3050 fermer	Prill – Maj (varësisht se kur hapet thirrja nga MBPZHR)

- Do të organizojmë shërbime këshillimore për fermer në kuadër të **projektit**: “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avansimit të shërbimeve Këshillimore të financuar nga MBPZHR dhe implementuar nga Qendra Kosovare për Zhvillim-KDC, mbjellja pranverore të kulturave bujqësore.

- Përcjellja e mbjelljeve pranverore për të parë më afër ecurinë e punëve agroteknike, duke iu ofruar këshillat e nevojshme fermerëve për mbjelljet, në mënyrë që të kenë rendiment dhe cilësi të kënaqshme.
- Pas publikimit të listës për sa i përket thirrjes publike **Përkrahja e fermerëve me PLEH ARTIFICIAL**, gjatë kësaj periudhe do të kryejmë, participimin e 20%, nënshkrimin e kontratave me fermer përfitues si dhe shpërndarjen e plehut gjatë muajit maj.
- Shpërndarja e preparatit për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit si dhe Spërkatja me këtë preparat planifikohet të bëhet gjatë muajit maj.
- Si proces mjaft i rëndësishëm në këtë periudhë kohore do të jetë edhe shpallja e ankandit publik për dhënien e tokës bujqësore komunale me qira. Të gjitha procedurat do të iniciohen duke u bazuar në ligjet në fuqi për dhënien e tokës komunale bujqësore me qira.
- Përcjellja e projekteve kapitale, si: Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore, Ndërtimi i kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore, Ndërtimi i infrastrukturës në tregun e Rrushit, Ndërtimi i objektit- Depos bujqësore, e projekte të tjera do të jetë fokusi kryesor i zyrtarëve të drejtorisë.

Objektivat kryesore në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2025

- Përfundimi me sukses i fazës së aplikimit për subvencione në kuadër të MBPZHR-së
- Inicimi i procedurave për shpallje të tenderëve për investime kapitale nga buxheti i ndarë për drejtorinë e bujqësisë
- Vaksinimi i bagëtive të trasha dhe të imëta.
- Hapja e thirrjeve Publike "Përkrahja e Fermerëve Vreshtarë me preparate për luftimin e insektit "CIKADIA" e hardhisë së rrushit", si dhe "Përkrahja e fermerëve me PLEH ARTIFICIAL".
- Përcjellja dhe monitorimi i mbjelljeve pranverore, si dhe raportimi në Ministrinë e BPZHR-së
- Shërbime këshillimore për fermerët.
- Përcjellja dhe monitorimi i ndërtimit të serrave.

Tremujori i tretë: korrik, gusht, shtator

- Fillimi i këtij tremujori do të jetë me fushatën e korrje-shirjeve, që edhe do ta karakterizojnë periudhën e tretë të vitit. Do të formohet komisioni për përcjelljen e procesit të korrje-shirjeve deri në përfundim të kësaj fushate duke e përcjellë me raport detal për Ministrinë e BPZHR-së.

- Edhe gjatë vitit 2025 tradita e vjeljes së rrushit do të organizohet gjatë muajit shtator, ku komuna e Rahovecit do të ofrojë mbështetje të OJQ-ve rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së festave me karakter bujqësor si: Festa e vjeljes së rrushit - HardhFest, Agrofesta, Panairi i produkteve të fund-vitit etj.

Ky tremujor do të karakterizohet poashtu me thirrjen për aplikim për subvencione për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 si dhe për sasi të kg të grurit dhe dëshmime të faturave të plehut, thirrje kjo që hapet nga Ministria e BPZHR-së.

Pranimi i aplikacioneve për qumësht, viça, për sasi të kg. të grurit, dhe faturave të plehut.	Aplikuesit	Koha e Realizimit
Plotësimi i dokumenteve dhe futja në sistemin eRF dhe LPIS	800	Gusht

Për shkak të temperaturave të larta gjatë kësaj periudhe zjarret në pyje përhapen shumë lehtë, prandaj si synim i DBPZHR-së, konkretisht sektori i pylltarisë do të jetë që të parandalojë përhapjen e zjarreve, pra do të ketë angazhim maksimal për parandalim të zjarreve në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Tremujori i katërt: tetor, nëntor, dhjetor

- Ky tremujor karakterizohet me përcjelljen e vjeljeve të prodhimeve vjeshtore, pos vjeljes së prodhimeve, i rëndësishëm është edhe procesi i mbjelljeve vjeshtore, për këtë periudhë rëndësi të madhe ka procesi i mbjelljes së kulturës së grurit si kulturë strategjike në nivel vendi.
- Vizitat në terren janë synimi jonë për këtë periudhë, pasi që në këtë kohë bëhet vjelja e rrushit, vizitat do të fokusohen në bodrume për grumbullim të rrushit si dhe përpunueseve të perimeve në tërë territorin e komunës sonë.
- Prioriteti kryesor e që është edhe për tërë vitin do të jetë realizimi i buxhetit të drejtorisë i ndarë për vitin 2025, do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri duke zbatuar projektet kapitale që shërbejnë për zhvillimin më të hovshëm të bujqësisë në komunën tonë.
- Shpallja e ankandit publik për dhënien e tokës bujqësore komunale me qira. Të gjitha procedurat do të iniciohen duke u bazuar në ligjet në fuqi për dhënien e tokës komunale bujqësore me qira

- Do të organizojmë shërbime këshillimore për fermer në kuadër të **projektit**: “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avansimit të shërbimeve Këshillimore të financuar nga MBPZHR dhe implementuar nga Qendra Kosovare për Zhvillim-KDC, prodhimi i kulturave bujqësore në ambient të mbyllur (serra).

Objektivat kryesore në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2025

- Fushata e korrje-shirjeve .
- Thirrja për aplikim për subvencione për qumësht, viqa, të sasisë së kg të grurit dhe faturave të plehut.
- Organizimi i festave që kanë karakter promovimin e produkteve bujqësore të komunës sonë.
- Përcjellja e investimeve kapitale.
- Vizitat në terren.
- Përcjellja e mbjelljeve vjeshtore.
- Shërbime këshillimore për fermerët.
- Realizimi i buxhetit të drejtorisë.

PËRFUNDIM


Plani i punës i hartuar nga drejtoria e BPZHR-së është plan ambicioz që përfshinë në vete shumë aktivitet duke i prekur të gjithë sektorët e bujqësisë.

Ky plan mund të devijoj dhe të ketë mospërputhje duke u nisur nga fakti që në sferën e bujqësisë mund të ketë situata të pa parashikuara nga fatkeqësitë natyrore ku mund të numërojmë: breshri, shira të shumtë që shkaktojnë vërshime, temperatura të ulëta, temperatura të larta etj.

Përveç fatkeqësive natyrore, plani mund të devijojë edhe për shkak të aktiviteteve të përbashkëta me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, mund të mos përshtatet koha e hapjes së thirrjeve për pagesa direkte, thirrjeve për skemën e grante etj.

Stafi i DBPZHR-së është i përkushtuar që maksimalisht të zbatojë këtë plan njëvjeçar duke mos pasur shkoputje nga aktivitetet e viteve paraprake e poashtu duke krijuar vazhdimësi për vitet në vazhdim të harmonizuar edhe me strategjinë e zhvillimit të Bujqësisë 2022-2027 që është miratuar në nivelin qendror.



Drejtor i DBPZHR-së

 Berat Duraku